



NGJALLJA

Nr. 3 (146) Viti XIV i botimit

MARS 2005

Çmimi 20 lekë

Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, me kushte dhe mësimdhënie bashkëkohore

Mjedise të reja komode, me klasa të bollshme dhe mësimdhënie të niveleve të larta profesionale. Këto janë faktet që të tërheqin vëmendjen gjatë një vizite të zakonshme në Institutin

e Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, në kryeqytet.

Kanë kaluar vetëm pesë vite jetë që nga dita e parë e hapjes dhe vazhdon të shërbejë si një nga qendrat më të rëndësishme në përgatitjen profesionale të të rinjve shqiptarë. Ky institut me program dyvjeçar është i pari i këtij lloji në Shqipëri, dhe një ndër më të frekuentuarit në Tiranë. I vendosur që prej një viti në ambientet e reja pranë kryqëzimit të Unazës me Rrugën e Durrësit, Instituti ofron kushte bashkëkohore të niveleve evropiane. Janë rreth 250 studentë që ndjekin programe të përpunuara në degët: kuadër menaxher dhe administrator për ndërmarrje, specialistë në llogari të kompjuterizuar, laborant për laboratorët mikrobiologjikë, klinikë dhe biokimikë, programues për programet e informatikës, restaurator veprash arti dhe specialist për ikonografinë bizantine. Cilësia e mësimdhënies në këto vite të para të funksio-

nimit është rritur pasi në këtë shkollë ekziston një staf pedagogjik i kualifikuar dhe me përvojë universitare, ku një pjesë e pedagogëve janë me grada dhe tituj shkencorë.

Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie” u krijua me iniciativën dhe mundësitë e siguruar nga Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas. Ky institut ka një profil të mirëfilltë profesional në fushat që u ofron të rinjve që kanë përfunduar gjimnazin.

Programi i studimeve është i njëjtë me atë të organizimit mësimor “Delta” në Greqi si dhe me shkollat e tjera analoge në vende të ndryshme të Evropës. Specialitetet që u ofrohen të rinjve janë bashkëkohore dhe janë me interes për tregun e punës në vendin tonë.

Degët janë të profilizuara në mënyrë tepër bashkëkohore dhe të interesuarit njohin anën praktike të zbatimit të tyre. Për këtë arsye është siguruar me kuj-

(vijon në faqen 3)



Pamje nga një orë mësimi në laboratorin e informatikës

Nderimi i ikonave



Në vitin 2002 në Greqi ndodhi një eveniment i veçantë shpirtëror: Nga Jerusalemi erdhi, duke kaluar nga Selaniku dhe më pas në Athinë, ikona mrekullibërëse e së Tërëshenjtës jerusalemitise (Panajia Ierosolymitissa), që u vendos në katedralet orthodhokse të të dy qyteteve dhe u nderua me veneracion nga besimtarët. Disa vite me parë, e njëjta gjë kishte ndodhur me ikonën “Aksion Estin” (“Të meriton...”), nga Mali i Shenjtë. Në të dy rastet e Tërëshenjtës u nderua nga miliona njerëz. Kjo dukuri ngjalli interes të veçantë për mediat dhe opinionin e gjerë. Por, dukuri të tilla kanë ndodhur edhe në vende të tjera, ku pranë ikonave mrekullibërëse afrohen me nderim të thellë dhe besim të patundur besimtarët. Edhe në vendin tonë ikonat janë veneruar dhe kanë ndodhur mrekulli. Ndaj, është me vend, që në prag të Ditës së Orthodhoksisë, kushtuar rivendosjes së nderimit të ikonave, të japim edhe një herë pozicionin e Kishës Orthodhokse për nderimin e imazheve të shenjta dhe vendin që ato kanë në jetën e Kishës.

Ikonografia dhe nderimi i ikonave të shenjta, që nisin nga periudha apostolike, u zhvilluan në mënyrë të (vijon në faqen 2)

• Faqe 4

Një traditë,
e cila jeton së bashku
me qytetin

• Faqe 5

Studentët orthodhoksë
të Qytetit Studenti,
të përkushtuar në lutje
e besim

• Faqe 5

2005-a, vit i pasur
me veprimtari për rininë
orthodhokse

• Faqe 6-7

Çjerrja e maskës së një
“superpatrioti”

• Faqe 8

Ata që punuan
për Kishën tonë

• Faqe 9

Dashuria nuk mund
të shuhet me artikuj
mendjesh të sëmura...

• Faqe 10

Nga shenjtoret
e muajit

• Faqe 11

Këshilli Botëror i
Kishave aprovon
vendimarrjen me
konsensus

• Faqe 12

Kisha e Kryeengjësve në
Gjirokastrë
- e drejtë ende e mohuar -

(vijon nga faqja 1)

jashtëzakonshme në shek. IV, në kohën e artë të teologjisë së etërve të mëdhenj. Sipas saj, është e domosdoshme të paraqesësh personin e Krishtit, meqë Biri është Fjala e Perëndisë e mishëruar dhe hyjnizoi natyrën njerëzore, duke e marrë atë. Është mirë gjithashtu të paraqesësh Virgjëreshën Mari dhe shenjtorët, sepse ata marrin pjesë në hyjnizim, duke qenë pjesë të trupit të Krishtit, pra Kishës. Dhe pikërisht për këtë motiv besimi në Krishtin, si edhe raportet me Të, nuk mund të bëhen pa paraqitjen ikonografike: trupi i Krishtit është i dukshëm dhe real, jo imagjinar dhe i paraqytuar.

Në shekujt VIII-IX u shfaqën ikonoklastët (ikonathyesit) e çdo lloji, që mbronin këndvështrimet judaïke, myslimane dhe të një vargu herezish. Për një periudhë të gjatë kohe, të dy kampet kundërshtarë paraqitën pozicionet e tyre. Pikërisht për të përballuar këtë problem, u mbledh Sinodi VII Ekumenik (Nikea 787), meqë Kisha akuzohej “nga judenjtë, nga saraçenët, nga paganët, nga maniketë” dhe nga heretikë të tjerë (Aktet e Sinodit VII Ekumenik). Ky Sinod vendosi që imazhet e veneruara dhe të shenjta të Krishtit, Perëndilindëses dhe ato të engjëjve e shenjtorëve - të bëra me ngjyra, mozaikë dhe çdo material tjetër të përshtatshëm - duhet të venerohen “në mënyrë gati të njëjtë me shenjtën e

Nderimi i ikonave

Kryqit, i denjë për nderim, dhe gjallërues”. Përveç këtyre, afirmohet që nderimi ndaj ikonave të shenjta “kalon tek origjinali” dhe kush lutet me përlësi para ikonës “përulë përpara hipostazës së atij që është shkruar në të”. Dhe Sinodi përfundoi: “Ja tradita e Kishës uni-



Ikona e ikjes nga parajsja të Adamit dhe Evës

versale që ka marrë Ungjillin nga një cep i tokës tek tjetri” (Aktet e Sinodit VII Ekumenik).

Ikonat e shenjta të Kishës sonë i përkasin artit të shenjtë dhe pikturës bizantine. Megjithatë, nuk japin një imazh të thjeshtë religjioz, një paraqitje natyraliste, tema e së cilës është një personazh apo një histori fetare. Ato konsiderohen nga besimtarët, dhe vërtet janë, si “enë të shenjta” liturgjike të pazëvendësueshme, që shenjtërojnë njeriun dhe që e bëjnë të hyjë në raport të drejtpërdrejtë me hirin dhe hipostazën e personit të paraqitur, sepse deri edhe material është e shenjtëruar në gjirin e Ki-

shës. Shën Theodhori, igumeni i manastrit të Studhiut, thotë: “*Është hipostaza e personit të rafiguruar që prezantohet dhe jo natyra e tij*”. Ikonat zbulojnë këtë realitet, të paarrtshëm për sytë. Ato na tregojnë dhe na mësojnë jo si të shikojmë Zotin tonë, Perëndinë, në

mizerjen ku gjendemi, por si të bëhemi pjesëtarë të pasurisë së Tij.

Ndaj, është krejt e pamundur të përjasësh ikonat e shenjta me idhujt, si përpiqen të bëjnë kundërshtarët e tyre të çdo kohe. Arsyt kryesore për këtë janë si më poshtë:

1-Ikonat e shenjtorëve të Kishës përfaqësojnë persona historikë dhe fakte reale, të lidhura personalisht dhe thelbësisht, me një raport të drejtpërdrejtë shenjtërie dhe pjesëmarrjeje, me të vetmin dhe të vërtetin Perëndi.

2-Ikonat e shenjtorëve janë objekt venerimi, ndërsa kulti është i destinuar vetëm për Perëndinë

Triadik, që u zbulua nga Biri dhe Fjala e Perëndisë, që u mishërua me anën e Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari.

Shën Tarasi, Patriku i Konstandinopojës, kryetar i Sinodit, sjell atë për të cilën shenjtorët martirë përgjigjeshin kur akuzoheshin që nuk pranonin të nderonin idhujt dhe se kishin idhujt e tyre, pra ikonat: “*Ne nuk paraqesim demonë, por Fjalën e mishëruar të Perëndisë dhe shenjtorët e Tij, por pa i hyjnizuar ikonat e tyre*” (Aktet e Sinodit VII Ekumenik).

Si rrjedhim, arsyet që, konform teologjisë së etërve, kërkojnë venerimin e ikonave të shenjta janë këto: “*sytë e shikuesve janë edhe ata të shenjtëruar nga ikonat e shenjta dhe, nëpërmjet tyre, shpirti çohet të njohë Perëndinë*” (Synodikon i Orthodhoksisë). Kështu shprehet nevoja nga ana e besimtarëve për të përqendruar mendimin dhe shpirtin tek ata të cilëve u drejtohet lutja e tyre, e përgjërimeve të tyre, por edhe i lavdithurjes dhe falënderimit, pra mbi shenjtorët e paraqitur. Vlera e madhe didaktike e ikonave tregohet edhe nga vendi që ato zënë në kisha dhe në kultin hyjnor. Falë këtyre “*librave folës*”, sipas Shën Grigorit të Nisës, çdo i krishterë njeh çmimin që Perëndia dhe Kisha u japin atyre që në tokë i mbeten besnikë vullnetit të Tij dhe u treguan të denjë për vdekjen në kryq dhe veprën shpëtuese të Perëndisë që u bë njeri.

(vijon nga faqja 1)

desin e drejtpërdrejtë të Kryepiskopit Anastas gjithë baza materiale e nevojshme për ngritjen e laboratorëve të ndryshëm mësimorë modernë, që janë të domosdoshëm për formimin profesional të studentëve. Për degën e mikrobiologjisë është krijuar një laborator mjaft i përshtatshëm i niveleve evropiane. Edhe për degën e restaurimit të veprave të artit është krijuar një laborator i ri mësimor.

Një investim serioz është bërë në ngritjen e dy laboratorëve modernë të informatikës. Në ta studentët marrin njohuri bashkëkohore për programe të ndryshme si dhe mësojnë mënyrat moderne të programimit dhe të kompjuterit.

Në dy degët ekonomike studentët përgatiten për të qenë nëpunës

Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, me kushte dhe mësimdhënie bashkëkohore

të specializuar në firma apo ndërmarrje shtetërore dhe private.

Një rëndësi të veçantë ka dega e ikonografisë bizantine, artit më të vjetër dhe më përfaqësues të vendit

tonë. Në këtë degë formohen piktorë të rinj ikonografë, të cilët dëshirojnë të vazhdojnë traditën e vjetër të pikturës shqiptare, si dhe të zbulojnë kishat e ndërtuara në këto



Pamje nga kabineti i ikonografisë dhe laboratorit i mikrobiologjisë

vite me ikona dhe afreske të reja.

Gjithashtu, programi mësimor i Institutit u ofron të gjithë studentëve edhe përvetësimin e disa gjuhëve të huaja.

Studentët vijnë nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë dhe shfaqin interesim të madh për përvetësimin e lëndëve të programit të shkollës duke pasur rezultate të kënaqshme në studimet e tyre. Pjesa më e madhe e studentëve që kanë dalë nga ky institut janë punësuar në kompani, firma si edhe ndërmarrje shtetërore e private, duke i shërbyer tregut dhe nevojave të punës në vend.

Isidor Koti

Kreshma e Madhe

Kjo kreshmë quhet “e madhe”, nga ana e cilësisë dhe rëndësisë së saj, sepse na përgatit për kungimin, për pjesëmarrjen në Javën më të Madhe dhe më të rëndësishme të jetës tokësore të Perëndinjeriut, të Krishtit, d.m.th., na përgatit për javën e pësimeve dhe Ngjalljes. Por Kreshma është e Madhe edhe nga ana sasiore, d.m.th. nga kohëzgjatja e saj. Fillon me të Hënën e Pastër (të Bardhë) e deri tek e Diela e Palmave (Dafinave), me qëllim pastaj ta plotësojë Java e Madhe.

Por ajo është e Madhe edhe për nga mënyra se si mbahet, për nga rreptësia. Po të mbahet në mënyrë të plotë dhe të saktë nuk hahet vaj dhe nuk pihet verë, përveç të shtunave dhe të dielave. Ditën e Ungjillëzimit dhe të Dielën e Dafinave hahet edhe peshk.

Shënojmë se shumë murgj dhe disa laikë, kur kreshmojnë duke mos konsumuar vaj hanë vetëm një herë në ditë. Kjo është mënyra strikte e zbatimit të Kreshmës së Madhe. Por patjetër është edhe ekonomia, d.m.th. rregullimet sipas kushteve dhe të dhënave të njeriut. Kjo është diçka që rregullohet në bashkëpunim me atin shpirtëror.

Po, është e rreptë Kreshma e Madhe! Me të drejtë një tropar që psalet në shërbesën e Mbrëmësore, ditën para fillimit të saj, thotë se Kreshma është një det i madh derisa të arrijë ngjallja triditëshe e Zotit tonë Jisu Krisht, që shpëton shpirtat tanë. Kreshma e Madhe është kreshma më e vjetër, së bashku me kreshmimin e të mërkurave dhe të premteve. Kreshmat e tjera u futën më vonë dhe gradualisht. Si prototip i Kreshmës së Madhe është kreshmimi dyzetditor pa ngrënë asgjë i Profetit Moisi, i Profetit Ilia dhe ajo e Jisu Krishtit. Moisiu kresh-

moi dyzet ditë pa ngrënë kur merrte ligjin në Malin Sina, Ilia kur ikte nga persekutimi i mbretëreshës idhujtare Jezavel dhe para se të shikonte të Lartin. Edhe kreshma e Jisuit, i cili pas pagëzimit dhe para se të fillonte veprimtarinë publike kreshmoi dyzet ditë pa ngrënë asgjë.

Shenja më e dukshme, sipas së cilës karakterizojmë kreshmën, është ushqimi, por mjerë ne nëse mbetemi atje dhe s’do shkojmë në thellësinë e saj. Kreshma është mjet, jo qëllim! Pra, me kreshmën na jepet rasti dhe ajo na ofron shumë mjete për udhëtimin dhe takimin me Çlirimtarin ditën e Dafinave, pastaj në Golgotha, në varr dhe deri në Ngjallje.

Po pse kreshmojmë? Kreshma është si pagesë, gjobë për ngrënien e ndaluar, kur gjarpri mashtroi Evën dhe ajo pa se ishte i mirë për ngrënien “fruti që më ka vrarë”, sipas një tropari, duke shkelur porosinë e parë ndaluese të Krijuesit. Kështu ata lanë një trashëgimi të keqe për gjithë botën, d.m.th. kënaqësinë, “ëmbëlësinë” e mëkatit të tyre, që u bë pararendës i mëkateve tona. “Çdo mëkat bëhet për kënaqësi dhe çdo ndreqje e tij bëhet nëpërmjet vuajtjes”, konstaton trishtueshëm një shkrimtar.

Kreshma ka baza biblike. Përmendëm rastet e Moisiut, Ilias dhe Krishtit, por ka edhe shumë pika të tjera në Shkrimin e Shenjtë që na detyrojnë për këtë, pra “të mbajmë kreshmë duke iu bindur traditës ungjillore”, thotë një tropar.

Edhe vetë Zoti kishte thënë se kur do të rrëmbet lart dhëndri atëherë nusja e Tij, Kisha, do të mbajë kreshmë (Mat. 9.15). Pra, kreshma e Madhe shfaq edhe nga ana e jashtme trishtimin për mëkatet tona që u bënë shkak të rrëmbet lart dhe të vihet mbi kryq Krishti.

25 Marsi - Ungjillëzimi i Hyjlindëses



Atëherë Maria tha: “Ja shërbëtorja e Zotit; le të më ndodhë sipas fjalës sate”. Dhe engjëlli u largua prej saj.

(Lluka 1:38)

Sot është nisja e shpëtimit tonë dhe shfaqja e misterit të përjetshëm; i Biri i Perëndisë bëhet i Biri i Virgjëreshës dhe Gabrieli ungjillëzon këtë gëzim. Prandaj, le t’i thërrasim Hyjlindëses: Gëzohu o Hirplote, Zoti është me ty.

(Përlëshorja)

Me zërin e kryeengjëllit le të thërrasim te ty, o virgjëreshë e kulluar: Gëzohu, o Hirplote, Zoti është bashkë me ty!

(Madhërimi)

Për Kreshmën e Pashkëve duhet të dimë se:

- Si rregull, gjatë saj nuk hahen mish, peshk, bulmet, vezë.

- Peshk hahet vetëm më 25 Mars, e kremtja e Ungjillëzimit dhe në të Dielën e Dafinave.

- Lejohet ngrënia e “frutave të detit”.

- Kur është e mundur kreshma mbahet pa ngrënë vaj ditët e javës (ose të paktën të premteve dhe të mërkurave), ndërsa të shtunave dhe të dielave përdoret gjithmonë vaji (me përjashtim të së Shtunës së Madhe).

- Verë pihet vetëm të shtunave dhe të dielave.

- Kushdo që ka probleme shëndetësore apo të tjera, që nuk e lejojnë ta mbajë kreshmën, duhet të bisedojë me atin shpirtëror.

Vajtimi, sipas Perëndisë, është trishtimi i shpirtit dhe prirja e një zemre të pikëlluar, e cila gjithmonë e kërkon marrëzisht atë për të cilën ka etje . . .

Vajtimi është një mamuze e artë në një shpirt, i cili është i zhveshur nga të gjitha lidhjet dhe pengesat . . .

Mbaje fort pikëllim-gëzimin e bekuar të vajtimin të shenjtë dhe mos pusho së punuari në atë derisa të të ngrejë lart mbi gjithçka të kësaj bote dhe të të paraqesë të pastër tek Krishti.

Fryti i vajtimin të sëmurë është lavdia e kotë dhe vetëvlerësimi, por fryti i vajtimin të bekuar është ngushëllimi.

Ai që është veshur me vajtimin e bekuar dhe hirdhënës . . . e njeh qeshjen shpirtërore të shpirtit.

Miq të mi, Perëndia nuk kërkon dhe as dëshiron që njeriu të vajojë nga pikëllimi i zemrës, por do që ai nga dashuria për Atë të gëzohet me qeshjen shpirtërore.

Kur shikoj natyrën aktuale të keqardhjes, habitem se si ajo që është quajtur vajtim dhe pikëllim përmban gëzim dhe ngazëllim brenda saj, si mjalti në huallin e bletës.

(Shkalla e Ngjitjes Hyjnore, Shkalla 7)

Korçë

Një traditë, e cila jeton së bashku me qytetin

E kremtja e 30 janarit nuk është shumë e vjetër si festë. Çdonjëri prej tre hierarkëve ka ditën e tij të kremtimit. Por, cilat ishin arsyet që vendosën këtë kremtim në Sinaksarin e janarit. I pari që përcaktoi këtë ditë ishte Mitropoliti i Efhaisë, Joan Mavropus. Shkaqet që sollën marrjen e kësaj nisme, sot duken disi të çuditshme, por atëherë ishin serioze.

sishme. Një nga detyrat e rëndësishme të Mitropolisë së Korçës në kohën e pushtimit osman ishte dhe arsimimi i fëmijëve të krishterë korçarë. Për këtë problem, si dhe shumë probleme të tjera të krishterët duhet të organizonin vetë jetën e tyre publike në komunitet.

Pushteti osman nuk përgjigjej për shkollimin e të krishterëve. Kjo politikë e osmanëve u mor hua prej

simimin e djemve të tyre. Kjo shkollë u ngrit në sheshin e Mitropolisë në verilindje të saj, (sot anekset e shkollës 8-vjeçare “Sevasti Qirjazi”) e cila vazhdoi të funksionojë deri më 1843 kur u rindërtua. Ambicjet e Fort të Ndririt Joasaf shkojnë deri atje sa kjo shkollë të ishte publike ku të mësonin të gjithë fëmijët (djem) edhe ata të fukarenjve pa pagesë. Ai mbledhi në

Arkihieratike dhe të lexohet në kishë kodiku i dhuratave shpirtërore. Në krye të këshillës popullore që qeveriste llason qëndronte mitropoliti i çdo kohe si i përhershëm.

Kjo traditë, e cila lidh Tre Hierarkët me përpjekjet për arsim dhe dije ruhet ende në këtë qytet, duke e shndërruar këtë festë në një festë arsimit dhe dijedashjeje. Ndoshta për vetë faktin se këto tri figura korifike të Kishës kanë arritur majat e dijes jo vetëm për kohën e tyre, por mbeten mjaft të vlefshëm gjithnjë, ku thellësia e mendimit dhe qartësia e arsyes së tyre janë të admirshme edhe sot. Mund të jetë kjo arsyeja që zellin për arsim dhe dije të krishterët e këtij qyteti e kishin lidhur me festën e - tre yjeve të shkëlqyshëm të dijes së Trinisë.

Edhe këtë vit u zhvillua monoklisia e drejtuar nga Mitropoliti i Korçës, Hirësia e Tij Imzot Joani, në kishën e Burimit Jetëdhënës. Por në kushte të reja, nuk u lexuan më emrat e dhuruesve të Llasos, por nga Mitropoliti i Korçës u celebrua një përshpirtje për të gjithë këta njerëz, të cilët patën dhënë ndihmën e tyre dhe që do të kujtohen me respekt nga brezat. Kështu ky kujtim shërben edhe si shembull për komunitetin, i cili duhet të mos harrojë këto tradita të mbara dhe frytdhënëse të këtij qyteti. Tradita të cilat e bënë të famshëm në atë kohë edhe që e ruajnë ende emrin dhe vlerat e këtij qyteti.

Mihal Sonellari



Në foto:
Gjatë
meshimit në
kishën
“Burimi
Jetëdhënës”

Në fillimet e shek. të 11^{te} njerëzit e shkolluar të Konstandinopojës po ziheshin ndërmjet tyre se cili prej hierarkëve ishte më i vyer dhe i rëndësishëm. Disa mbështetnin Vasilin, disa Grigorin dhe të tjerë Gojartin. Kështu, të krishterët u ndanë në tri grupe: “vasilianë”, “grigorianë” dhe “joanianë”, të cilët kishin krijuar një gjendje shpërthyes. Joani, që të qetësonte situatën, vendosi kremtimin e tre hierarkëve më 30 janar dhe ky kremtim i përbashkët e arriti plotësisht qëllimin e tij në miqësimin e palëve.

Kjo festë kremtohet me një madhështi të veçantë edhe në qytetin e Korçës. E njohur me një emërtim të veçantë, si Tre Arkondët. Gjithmonë në këtë ditë zhvillohej Monoklisi, që celebronte nga Mitropoliti i Korçës në kishën e Burimit Jetëdhënës (Mitropoli). Po në këtë ditë nga Mitropoliti lexohej dhe lista e dhuruesve dhe mirëbërësve, e cila njihet me emrin “Llaso”. Por ç’ishte llasoja dhe përse shërbente.

Nevojat politike dhe shoqërore në periudha të veçanta historike i kanë vendosur Kishës gjatë shekujve detyra të shenjta dhe të rëndë-

traktatit shumë të vjetër të Kalifi Omar, që ai pati lidhur me Patriarkun Sofron të Jerusalemit, në vitin 637 pas Krishtit.

Gjatë shekujve të parë të sundimit turk në kushtet e diskriminimit fetar shkolla organizohej brenda në kishë. Këto shkolla morën emrin “shkolla qeli” dhe për këtë përdorshin hajatet e kishave. Punën e mësuesit e bënë priftërinjtë ose psaltët e kishës.

Në to mësoheshin shkrim, këndim dhe pjesë të thjeshta fetare, pak matematikë dhe bujqësi. Për të ngritur shkollën në një rang më të lartë dhe për të marrë formën e shkollës së plotë dhe që djemve korçarë t’u jepej arsim më i lartë me mjetet pedagogjike të kohës vendosën në drejtimin e Fort të Hirshmit Mitropolit të Korçës dhe më pas Patriark të Ohrit, Joasafit të ngrej në një shkollë të tillë më 1724. Për herë të parë në historinë e shkollave të Korçës janë mbledhur ndihma të mëdha me parullën “Për skoli dhe kishë”. Vetë i Hirshmi Joasaf figuron në ballë të ndihmëtarëve.

Të gjitha këto tregojnë për dëshirën e madhe të korçarëve për ar-

Mitropoli të gjithë ryfetet e qytetit, të cilët vendosën me vetëdashjen e tyre të mirë për shpëtimin shpirtëror. Dhanë dhuratë të përbashkët për shkollë shpirtërore, për shkollë të përbashkët që të gjithë të mësonin pa pagesë.

Në vitin 1850 fort i ndritshmi Mitropoliti i Korçës, Neofit Gjirokastro, duke kuptuar se korçarët kishin një traditë të flaktë për arsim dhe qytetërim, si edhe mbi bazën e traditës së lënë nga Fort i lumturi Joasaf mendoi që financimi i tyre duhej të kishte një themel vendas. Për këtë ai u mor vesh me tregtarë vendas, kurbetllinj edhe arkondë të Korçës. Kështu Mitropolia e Shënjtë e Korçës me Mitropolitin Neofit, epitropët e nderuar dhe së bashku me arkondët themeluan “Arkën Arsimore” më 1850 dhe e pagëzuan me emrin “Llaso”.

Për administrimin ekonomik të kësaj ndërmarrjeje më 12 nëntor 1876 u hartua dhe kanonizimi i arkës popullore “LLASO” të varoshit të Korçës i përbërë nga 12 nene dhe 5 kapituj.

Gjithashtu, ditën e Tre Arkondëve më 30 të janarit të bëhet meshë



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues: Kryepiskopi
Anastas**

**Del nën kujdesin e Këshillit
Botues**

Kryeredaktor: Thoma Dhima

**Adresa:
Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë**

Tel: (042) 34-117, 35-095.

Fax: 32-109

**Shtypur në shtypshkronjën
“Ngjallja”**

Veprimtari me të rinjtë orthodhoksë

Studentët orthodhoksë të Qytetit Studenti, të përkushtuar në lutje e besim

“Kur u luta u rinova, por kur pushova së luturi u plaka”, - ka shkruar një teolog i madh i krishterimit të hershëm. Në këtë frymë shpirtërore; me besim, lutje e vepra të mira, studentët orthodhoksë të Qytetit Studenti janë kthyer në një nga grupet rinore më unike.

Në një marrëdhënie të gjallë me Perëndinë, të rritur në lutjet personale dhe kolektive të përditshme, ata japin një shembull shumë të mirë tek bashkëmoshtarët e tyre kudo në Shqipëri.

Në fillim, si tek çdo besimtar, besimi lindi tek ata si një shkëndijë. Por me kalimin e kohës, kjo shkëndijë u bë flakë që çliron dhe jep energji në dëshminë e besimit të krishterë. Nuk janë të shumtë në numër, por përkushtimi i tyre është frymëzues në jetën shpirtërore. Ata përfjethen zjarrin e dashurisë së shenjtë të Perëndisë duke kultivuar çdo ditë lutje dhe duke pranuar të vërtetën që buron prej Zotit Krisht.



Një ndër veprimtaritë e këtyre të rinjve në prag të kreshmëve të mëdha ishte edhe agripnia e zhvilluar në fund të muajit shkurt. Koordinatorja e veprimtarive rinore në Qytetin Studenti, Ana Baba, na tha: “Është dëshira e vetë studentëve të bëjnë agripni, lutje çdo ditë dhe biseda biblike, sepse ata janë futur në jetën shpirtërore dhe gjith-

monë e më shumë kërkojnë që të bëjnë sakrifica për t’u rritur shpirtërisht dhe për të marrë bekimet e Perëndisë. Agripnia është një nga sakrificat më të mëdha që ata mund të ofrojnë në jetën shpirtërore. Aq më tepër që tani është edhe periudhë shumë e rëndësishme dhe agripnia të ndihmon në një analizë të vetes që ne të kthehemi tek

Perëndia me zemër të pastër, sa më shumë që të kemi mundësi”.

Veprimtaritë në Qytetin Studenti kanë nisur në vitin 1994, me iniciativën e At Theologut dhe Motër Filotheas. Këtë nismë e pasoi më tej At Luka Veronis, i cili me kërkesën e studentëve të Q. Studenti kërkoi hapjen e një kishë të vogël, e cila edhe pse modeste, në

ditët e para të themelimit e deri sot ka mbledhur mjaft studentë të qytezës të ardhur nga të gjitha qytetet e Shqipërisë. Kjo kishë funksionon në mjediset e marra me qira, në ish-kinoklubin e Qytetit Studenti, aty ku dhe u përqendrua veprimtaria katekiste e lëvizjes rinore orthodhokse. Që nga dita e parë e nisjes së këtij aktiviteti, takimet me të rinjtë bëhen dy herë në javë, të martën në orën 17⁰⁰ dhe të enjten në orën 06⁰⁰ të mëngjesit, kur zhvillohet Shërbesa e Mëngjesores dhe Liturgjia Hyjnore. Takimi i çdo të marte pasdite mbledh me dhjetëra të rinj, të cilët bëhen protagonistët e diskutimeve rreth tematikave të ndryshme shpirtërore e sociale. Puna me të rinjtë vazhdon edhe gjatë ditëve të tjera të javës në godinat e Qytetit Studenti ku zhvillohen studime biblike, katekizëm si dhe biseda shpirtërore e miqësore.

I. K.

2005-a, vit i pasur me veprimtari për rininë orthodhokse

Zyra Kombëtare e Rinisë Orthodhokse në bashkëpunim me zyrën e katekizmit zhvilluan në Tiranë një takim me katekistë dhe aktivistë, të cilët organizojnë dhe drejojnë veprimtaritë që organizon Kisha Orthodhokse me të rinjtë. Në qendër të takimit ishte analiza e punës për vitin 2005, në mënyrë që të vazhdojnë dhe të përmirësohen edhe më shumë veprimtaritë shpirtërore dhe kulturore në të gjitha dioqezat.

Theksi u vendos në veçanti në kampet verore, të cilat konsiderohen aktiviteti më i madh dhe më i rëndësishëm rinor. Gjatë dis-

kutimit, drejtuesit e grupeve rinore hodhën ide të ndryshme për pasurimin e kësaj veprimtarie dhe aktiviteteve të tjera në rang lokal dhe kombëtar. Për të forcuar lidhjet midis grupeve rinore është menduar organizimi i trajnimeve për të rinjtë që kanë interes në këtë projekt. Në bisedë u fol edhe për konferencat rinore, festivale, veprimtaritë sportive si edhe aktivitetet humanitare dhe sociale që iu vijnë në ndihmë jo vetëm të rinjve por edhe grupmoshave të tjera me probleme sociale.

Disa nga aktivitetet rinore, që do të zhvillohen në vitin 2005 janë: takime me



Gjatë vitit 2004 u zhvilluan shumë veprimtari me të rinjtë dhe fëmijët

grupet rinore, trajnime, konferenca me gjimnazistë dhe studentë, pelegri-

nazhe, veprimtari sportive, festivale lokale dhe kombëtare, kampe verore dhe di-

mërore, aktivitete me të rinjtë me aftësi të kufizuara etj.

I. Koti

Reagim i intelektualëve orthodhoksë të Korçës

Çjerrja e maskës së një “superpatrioti”

- Foti Cici për 13 vjet nuk i dha asgjë Kishës sonë dha tani përpiqet t'i vëjë shkopinj në rrota -

- Botuar në gazetën “KOHA JONË” dt. 12 shkurt 2005 -

Duke marrë shkas nga një numër artikujsh të shkruar nga atë Foti Cici, ndihemi të detyruar për të dhënë një përgjigje, jo atij, por lexuesve, që të kuptojnë se kush është me të vërtetë ky njeri dhe cilat janë qëllimet e tij. Në ato shkrime (ndonëse në pjesën më të madhe me një gjuhë të paqartë, duke kundërshtuar në paragrafin e dytë atë që pohon në të parin), ai e paraqet veten si apostulli i vetëm i shqiptarizmit në Orthodhoksi dhe se të gjithë klerikët e tjerë shqiptarë dhe shqiptaro-amerikanë e paskan tradhtuar Orthodhoksinë shqiptare. Ai përpiqet të zezojë gjithçka që ka të bëjë me Kishën Orthodhokse, duke hedhur baltë mbi të gjitha përpjekjet, zhvillimet dhe përparimet e kësaj kishë. Por realiteti i Kishës Orthodhokse tregon se është ndryshe. Ajo Kishë ka përparuar në të gjitha drejtimet. Është krijuar Akademia

Prandaj ndihemi të indinjuar kur dëgjojmë zëra që i përbaltin tërë këto vepra, dhe për më tepër tërë këta zëra vijnë nga njerëz që pretendojnë se janë teologë dhe klerikë. Një teolog dhe një klerik, siç pretendon të jetë Foti Cici, gëzohet me përparimet e kujtdo qoftë, nuk është smirëzi, nuk është karrierist dhe ziliqar dhe për më tepër nuk flet me atë gjuhë. Gjuha e tij e mbushur me urrejtje, përçarje dhe fyerje, që do të ishte e papranueshme edhe për një njeri të zakonshëm dhe jo më për një klerik, është në fakt një fyerje dhe cënim që i bëhet vetë atij dhe figurës së një kleriku dhe po bëhet precedent për diçka jashtëzakonisht negative. Detyra e klerikut është të sjellë paqe dhe dashuri edhe aty ku ka grindje dhe urrejtje dhe jo që t'i shtojë ato më shumë, siç po përpiqet të bëjë Foti Cici me shkrimet e tij. Në këtë

zakonshëm me të drejtë do të mund të thonë: “Edhe klerikët po shajnë si të tjerët”. Gjë që në fakt nuk është e vërtetë.

Atë Foti Cici nuk rresht sulmet dhe shpifjet kundër Kryepiskopit Anastas dhe klerikëve të tjerë të Kishës Orthodhokse. Ne e dimë ar-

faktori kryesor në këtë ringjallje të Kishës, duke siguruar mbledhjen e fondeve dhe duke u kujdesur personalisht në çdo vepër, qofshin ndërtime të ndryshme për të gjithë popullin shqiptar. Gjithçka që ai ka bërë këtu do t'i mbetet këtij vendi dhe kësaj Kishë. Për këtë ne e falënderojmë dhe e nderojmë. Ai e ka

Kryepiskopi Anastas e ka drejtuar Kishën me sakrifica të panumërta. Ai ka qenë faktori kryesor në këtë ringjallje të Kishës... Gjithçka që ai ka bërë këtu do t'i mbetet këtij vendi dhe kësaj Kishë. Për këtë ne e falënderojmë dhe e nderojmë.

syen përse. Duke mos dashur të sakrifikojë dhe të shërbejë, ai nuk pranoi të rrinte në Shqipëri, sepse ai do të qëndronte vetëm nëse do t'i jepeshin poste të larta në hierarkinë kishtare, duke mos kuptuar se kisha është një vend ku duhet të shërbesh dhe jo e kundërta. Dhe meqenëse kjo nuk iu plotësua, ky

fituar prestigjin dhe nderimin e tij në të gjithë botën, jo sepse është Kryepiskop, por nga vepra e tij e madhe misionare. Të nderohesh, s' do të thotë të kesh pozitë të madhe, por zemër të madhe. Nënë Tereza ishte një murgeshë e thjeshtë, por dashuria e saj e zjarrtë për Krishtin dhe për njerëzit e bënë simbol botëror të dashurisë dhe humanizmit. Ndonëse ajo nuk shërbeu në vendlindjen e saj, ajo u nderua nga vendi ku ajo kaloi pjesën më të madhe të shërbesës së saj misionare me një nderim të madh dhe u bë një nga njerëzit më të dashur për të gjithë. Kjo duhet të shërbejë si shembull edhe për ne, duke e treguar këtë gjë me mirënjohjen dhe nderimin tonë për ata që na kanë ndihmuar në çaste të vështira dhe jo t'i shajmë ata, siç bën Foti Cici.

Është mirë që lexuesit të njohin Foti Cicin e vërtetë. Orthodhoksët e Shqipërisë e njohin mirë atë, por është nevoja që ta njohin edhe të tjerët, për të kuptuar se cili është ai me të vërtetë. Atë Foti Cici nuk përfaqëson klerikët shqiptarë dhe as ata orthodhoksë. Ai njeri nuk ka asnjë lidhje me Kishën Orthodhokse dhe as me mesazhet dhe shërbesën e saj. Ai nuk duhet të ndërhyjë në çështjet e brendshme të Kishës, ngaqë ai nuk është anëtar i Kishës Orthodhokse në Shqipëri, por shërben në Kryepiskopatën Greke në Amerikën e Veriut, më saktë në Kanada. Ai nuk ka as të drejtën kanonike dhe as atë morale për të justifikuar ndërhyrjet, edhe sikur këto të ishin dashamirëse, gjë

956
ΕΡΑ ΜΗΤΡΟΠΟΛΙΣ ΤΟΡΟΝΤΟ
ΚΟΙΝΟΤΗΤΕΣ - COMMUNITIES
Canada - Alberta (ALTA)
1. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου, St. Nicholas Greek Orthodox Community, Calgary, Τηλ. (403) 246-4553, fax: (403) 246-8181. “Αγία Ελεονώρα” Αγ. Ελεονώρας Κοινότητα.
2. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου, St. George Greek Orthodox Community, Edmonton, Τηλ. (780) 452-7329, fax: (780) 452-1488. “Ελεονώρα” Αγ. Ελεονώρας Κοινότητα.
3. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community of Jasper, Τηλ. (780) 832-4594. “Ελεονώρα” Αγ. Ελεονώρας Κοινότητα.
British Columbia (BC)
4. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community Kamloops, Τηλ. (250) 826-0700, fax: (250) 826-0700. “Αγία Νίκη” Αγ. Νικολάου Κοινότητα.
5. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community of Abbotsford, Τηλ. (604) 855-1818, fax: (604) 855-1818. “Αγία Νίκη” Αγ. Νικολάου Κοινότητα.
6. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community of Port Moody, Τηλ. (604) 461-1239, fax: (604) 461-1239. “Αγία Νίκη” Αγ. Νικολάου Κοινότητα.
7. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community, Prince George, Τηλ. (250) 561-1239, fax: (250) 561-1239. “Αγία Νίκη” Αγ. Νικολάου Κοινότητα.
8. “Αγία Νίκη” Αγία Νικολάου Κοινότητα, Greek Orthodox Community of Surrey and Fraser Valley, Τηλ. (604) 855-1818, fax: (604) 855-1818. “Αγία Νίκη” Αγ. Νικολάου Κοινότητα.

“Superpatrioti” Foti Cici, që shpesh mbush gazetë shqiptare me artikuj antigrekë, në këtë foto të kohëve të fundit është duke celebruar me Mitropolitin e tij grek të Kanadasë, Sotirios, që varet nga Patrikana Ekumenike. Ndërsa majtas një faqe nga vjetari i Patrikanës Ekumenike për vitin 2005, ku figuron si klerik i saj në Kanada edhe F. Cici.



Teologjike, ku përgatiten klerikët e ardhshëm. 98 për qind e klerikëve që shërbejnë në kishë janë shtetas shqiptarë. Kisha është përfshirë në të gjithë jetën shoqërore të vendit. Për këtë kanë dhënë kontribut të madh shumë njerëz, nga brenda e jashtë vendit. Pa këtë ndihmë të madhe e pa këto përpjekje do ishte e pamundur kjo ringjallje e Kishës. Për këtë arsye komuniteti orthodhoks i falënderon të gjithë këta.

vend sherri le të ruhen të paktën të pastra, si një shembull edhe për të tjerët, institucionet fetare. Deri më sot klerikët shqiptarë e kanë treguar se janë të denjë për atë që përfaqësojnë. Kështu, të ashtuquajturit klerikë si Foti Cici, jo vetëm që u vënë njollë klerikëve shqiptarë, por edhe vetë komuniteteve fetare, sidomos në njerëz që nuk janë në kontakt me problemet reale të këtyre komuniteteve. Njerëzit e

klerik, që nuk e meriton këtë titull, me metoda të pahijshme pretendon të bëjë karrierë në kishë, duke fyer dhe përbaltur të tjerët, përveçse fetarisë. Një njeri i tillë nuk kupton se ata që drejtojnë sot kishën kanë shërbyer me devotshmëri dhe me dashuri. E kanë parë shërbesën e tyre, ashtu si i ka hije një kleriku, si një mision të shenjtë. Kryepiskopi Anastas e ka drejtuar Kishën me sakrifica të panumërta. Ai ka qenë

që duket qartë se nuk janë. Ai nuk është në juridiksionin e Kishës Orthodoxke Autoqefale të Shqipërisë dhe si një teolog që pretendon se i di kanonet, duhet ta dijë që kjo është një shkelje kanonike. Çdo kishë autoqefale drejtohet nga sinodi i asaj kishe dhe vetëm ai mund të vendosë për çështjet e administrimit dhe drejtimit. Çdo ndërhyrje në punët e brendshme të një kishe është pak a shumë si ndërhyrjet në jetën e brendshme të një shteti tjetër. Kur nuk i lejohet as peshkopëve dhe as primatëve të kishave të tjera që të ndërhyjnë në çështjet e brendshme të një kishe, çfarë mund të thuhet kur bëhet fjalë për një prift të rëndomtë!?

Nënë Tereza... ndonëse nuk shërbeu në vendlindjen e saj, u nderua nga vendi ku ajo kaloi pjesën më të madhe të shërbesës së saj misionare me një nderim të madh... Kjo duhet të shërbejë si shembull edhe për ne, duke e treguar këtë gjë me mirënjohjen dhe nderimin tonë për ata që na kanë ndihmuar në çaste të vështira dhe jo t'i shajmë ata.

Amerikë (tani së fundi edhe në shkrimet që boton në Shqipëri) “i persekutuar” nga grekët.

Meqenëse shqiptarët e Amerikës nuk e pranuan shkoi në Kanada, ku u përpoq të përdorte orthodhoksët shqiptarë të atij vendi, që për fat të keq nuk kanë pasur një famulli, për të rregulluar dokumentet e qëndrimit atje. Por meqenëse komuniteti shqiptar në Kanada nuk është në

tje personale çështje kombëtare”, o Zot na ruaj nga “patriotë” të tillë.

Patriot dhe atdhetar i vërtetë është ai që jep kontributin për ndërtimin dhe begatinë e këtij vendi dhe jo ata që shajnë të tjerët. Klerik i vërtetë është ai që sakrifikon dhe e vë veten e tij në shërbim të Kishës dhe jo “patriot” të tipit të Fotit që duhet ta vënë kishën në shërbim të interesave të tyre personale. Për

shërbejnë popullit të tyre. Dhe e kanë bërë këtë shërbim pa fjalë dhe pa mburrje. Për të tillë njerëz ka nevojë Kisha jonë dhe të gjitha komunitetet fetare.

Atë Foti Cici na ankohet në shkri-met e tij se si ai po vuan dhe persekutohet “në mërgim” në Evropë, Amerikë dhe Kanada. Ne besojmë se çdo njeri normal e kupton se të pretendosh që ai po vuan i persekutuar “në mërgim” në Amerikë dhe Kanada, dhe se klerikët këtu po gëzojnë të gjitha të mirat në këtë vend, nuk është serioze. Klerikët e të gjitha komuniteteve fetare të Shqipërisë po jetojnë në kushte të vështira, duke u përpjekur çdo ditë nëpër gjyqe e konflikte për të marrë pronat dhe për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve. Dhe në këto përpjekje të mëdha të gjithë klerikët e Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në rimëkëmbjen e këtij vendi dhe duke u bërë edhe për të tjerët një shembull durimi e tolerance. T’i mësohet ata nga Amerika se çfarë ata duhet të bëjnë nuk është e moralshme, sidomos nga njerëz që u janë shmangur sakrificave dhe përgjegjësi në këtë vend. Kisha jonë ka nevojë për njerëz që të japin kontribut në ndërtimin e saj dhe jo për ngatërrestarë, që për hir të qëllimeve të tyre banale, janë gati t’i vënë flakën, jo vetëm kishës, por edhe gjithë vendit. Ne shprehim bindjen e plotë se komuniteti orthodhoks i udhëhequr nga hierarkët e tij, nuk do të lejojë që njerëz të tillë të dëmtojnë përparimin e Kishës sonë dhe njerëz të tillë nuk kanë dhe as do të kenë vend në Kishën Orthodoxke dhe as nuk do të gjejnë mbështetje nga komuniteti orthodhoks.

Një grup intelektualësh nga Korça

Tomi Piluri	Pneumolog
Grigor Mulla	Matematikien
Vaskë Stasa	Ekonomist
Nesti Terova	Agronom
Ana Gusho	Mësuese
Lilika Melko	Teknologe
Vasillaq Kollaci	Muzikolog
Dhimitra Totonozi	Mësuese
Natasha Teneqexhi	Ekonomiste
Jovan Zisi	Ekonomist
Elena Koçi	Farmaciste
Silvana Helmësi	Mjeke
Kostaq Kanari	Inxhinier kimist
Pandeli Napuçe Prof. Univ. “Fan Noli”	
Niko Face Prof. Univ. “Fan Noli”	

SILOGU I ALIQIOTEVE TE SARANDES - VORIO EPIRIT SE ZONES SE ATHINES (Rruga Themistokleous 31. tel.)

-VORIO EPIRI, I LIRE, GREK-

Nr. Prot. 85 , Athinë 13.11.1992

VERTETIM

Vërtetohet se z. **Fotios Cici**, i Grigorit dhe i Aleksandrës, lindur më 6.7.1968 në Sarandë e me origjinë nga Nivica e komunës së Lukovës të Rrethit të Sarandës së Vorio Epirit, shtetas shqiptar dhe i krishterë orthodhoks **është me kombësi greke**. I lartpërmenduri ka letërnjoftim me nr. 277860, autentik sipas deklarimit të tij, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Piqerasit - Sarandë.

Ky vërtetim lëshohet për leje qëndrimi.

SEKRETARI I PERGJITHSHEM
GEORGIOS PAPPAS

KRYETARI
VASILIOS MASSIOS

Gjithashtu ai nuk ka as të drejtën morale për t’i dhënë mësim patriotike kishës këtu, sepse ai nuk e përfaqëson patriotizmin shqiptar, por për njerëz të këtij lloji për fat të keq, “patriotizmi” mbetet streha e fundit. Ky mbrojtës i “shqiptarizmit”, u pagëzua nga ish - Mitropoli i Konicës, Sebastiani dhe u dërgua me bursë po nga ai të studiojë në Athinë. Atje iu drejtua me një kërkesë Ministrisë së Jashtme të Greqisë ku mohonte identitetin e tij si shqiptar dhe kërkonte të njihet si grek (për këtë mund të japim edhe kopjen e kërkesës së tij). Për sa kjo i nevojitej, ai hiqej si grek, duke përfutur gjithçka që mundte nga kjo. Kur kjo nuk i shërbeu më qëllimit të tij, rrëmbeu flamurin e patriotizmit dhe filloi të fliste për shqiptarizëm. Duke njohur mirë se çfarë grupe të ndryshme duan të dëgjojnë ai e ka shfrytëzuar vazhdimisht këtë për interesat e tij. Në Greqi ishte grek, në Amerikë (më saktë të shqiptarët e Amerikës), u hoq fanolist. Në Greqi paraqitej “i persekutuar” nga shqiptarët dhe në

gjendje të paguajë një klerik me rrogë të plotë, ky “patriot” që jep mësim patriotizmi dhe sakrifice për atdheun, e la famullinë shqiptare dhe shkoi të “sakrifikohet” në një kishë greke, e cila fatmirësisht për atë, ka edhe një pagesë të majme. Në kushtet e krijuara nga famullia greke, në një zyrë të rehatshme dhe të ngrohtë po në kishën greke, ky “patriot” shqiptar i jep leksione shqiptarizme dhe përcakton se kush është shqiptar dhe jo, kush është orthodhoks i vërtetë dhe kush jo, kush sakrifikohet për mëmëdheun e tij dhe kush jo. Interesat e tij personale ai përpiqet t’i veshë me petkun e shqiptarizmit. Kishte të drejtë Faik Konica kur shkruante se “shqiptarët janë të tmerrshëm që ta bëjnë çdo çështje

fatim tonë të mirë në Kishën tonë kemi klerikë të sakrificës që e kanë vënë veten në shërbim të Kishës dhe të vendit të tyre. Shembulli më i mirë është ai i Mitropolitit të Dioqezës së Korçës, Imzot Joanit, i cili ndonëse ishte në Amerikë dhe komuniteti shqiptar dhe Kisha Orthodoxke e Amerikës i ofruan atij gjithçka dhe kërkuan me ngulm që të qëndronte atje, ai nuk i pranoi këto oferta, por erdhi të shërbejë këtu, duke dhënë kontributin e tij në rimëkëmbjen e Kishës Orthodoxke dhe duke shërbyer me devotshmëri dhe përlusësi. Gjithashtu edhe shumë klerikë të tjerë, që ndoshta kishin mundësi të shkonin “në mërgim” si atë Foti Cici, por nuk e kanë bërë. Kanë preferuar të qëndrojnë këtu dhe t’i

...të gjithë klerikët e Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në rimëkëmbjen e këtij vendi dhe duke u bërë edhe për të tjerët një shembull durimi e tolerance. T’i mësohet ata nga Amerika se çfarë ata duhet të bëjnë nuk është e moralshme, sidomos nga njerëz që u janë shmangur sakrificave dhe përgjegjësi në këtë vend.

Ata që punuan për Kishën tonë

At Kostandin Bozdo



Lindi në vitin 1902, në fshatin Koshovicë, nga një familje klerikësh me tradita. I ati i tij ishte prift dhe shërbeu edhe ai në fshatin e vet si edhe në fshatrat përreth. Kostandini u rrit në një mjedis thellësisht të krishterë dhe andej buroi edhe dashuria e tij për Krishtin. Shkollën fillore dhe plotoren e mbaroi në Greqi. Pas vdekjes së babait të vet (1942) u hirotonis nga mitropoliti i Gjirokastrës. Shërbeu në fshatrat Koshovicë, Sofratikë, Selo dhe Klishar. Mitropolia e Hirshme, për veprën e tij, e nderoi me titullin e Stavroforit dhe e caktoi si përgjegjës të Manastirit të Shenjtë të Shën Triadhës së Pepelit. U përpoq për rimëkëmbjen e manastirit të shkatërruar nga gjermanët, dhe në ato vite të vështira riorganizoi kremtimin dhe panairin madhështor të manastirit.

Pasioni për ruajtjen e besimit orthodhoks në zonën e tij, ku propaganda e vazhdueshme e sistemit ateist përpiquej ta shkulte nga zemrat e besimtarëve të krishterë, pati si rezultat ta akuzojnë, ta arrestojnë dhe gjashtëmbëdhjetë muaj t'i kalojë nën torturat çnjerëzore.

Më 30 shtator 1964 u dënua me vdekje, me akuzën e tradhtisë ndaj atdheut dhe u ekzekutua në vend të panjohur deri më sot.

Korresp. i "Ngjalljes"

Ikonom At Harallamb Ikonomi

Harillao (Harallamb) Ikonomi, pasardhës i një familje mjaft të kulturuar, ka lindur rreth vitit 1858 në fshatin Skore të Pogonit. Pasi mbaroi shkollën plotore në fshat u dallua si njeri i dhënë pas librave, prandaj familja e dërgoi në Zosimea të Janinës, të cilën e mbaroi me vlerësimin shkëlqyeshëm e pastaj në Shkollën e Lartë të Kombit në Stamboll, studime të cilat i mbaroi më 1878. Po atë vit, u emërua mësues në fshat, ku punoi deri më 1884; pastaj kaloi si mësues në shkollën qendrore të Dhrovjanit, ku vazhdoi deri më 1902. Më 1903 e deri më 1913 punoi përsëri si mësues në shkollën e fshatit të tij të lindjes. Gjatë tërë kohës së tij të punës ra në sy për devotshmëri në detyrë, për besim të pastër tek Perëndia, për punë të përkushtuar në familje, ku bazë e jetës ishte morali i krishterë. U martua me Fotininë nga Janina, e cila në vitin 1879 erdhi në Skore si mësuese, ku organizoi dhe vazhdoi për shumë vite në shkollën e fshatit programin mësimor të avlëmendit dhe të qëndisjes për vajzat e fshatit. I lindën dy fëmijë. Djali Jorgo, mbasi mbaroi Zosimean, emigroi në Aleksandri të Egjiptit, ku u dallua jo vetëm si njeri i kulturës, por dhe një aktivist i zoti për orthodhoksët e atjeshëm.

Virtytet e veçanta të Harillaos dhe kërkesat e besimtarëve bënë që ai të vendosë të hyjë në jetën klerikale. Më 6 janar 1913 ai u hirotonis dhjak në Leshnicën e Sipërme dhe më 7 janar u vesh prift në Leshnicën e Poshtme. Ai njihet nga të gjithë dhe kudo si Papa Harallambi. Në kishat e këtyre

fshatrave shërbeu si meshtar deri në vitin 1916. U transferua si prift dhe mësues me qendër në Libohovë, por shërbeu mjaft kohë dhe në Suhë. I dalluar mes priftërinjve të Mitropolisë së Gjirokastrës (për njohuritë e tij, për shërbesat cilësore që kryente, për personalitetin e tij imponues, për zërin melodioz) u vlerësua dhe u nderua dhe me titullin Ikonom, madje për disa kohë kryente dhe detyrat e zëvendësepskopit të Mitropolisë. 25 vjetët e fundit i kaloi në Libohovë, ku edhe ndërroi jetë më 1941. Popullsia e atjeshme e ka nderuar shumë këtë njeri aq sa edhe sot mbahet mend nga të moshuarit si një ndër njerëzit e mençur, i devotshëm në detyrë dhe shumë komunikues, pra shembull i një kleriku të përsosur.

Ka qenë njeri me kulturë të gjerë, që lexonte shumë dhe ishte në kontakt të vazhdueshëm me librat. Ka pasur një bibliotekë shumë të pasur. Mund të themi se ishte biblioteka më e pasur dhe më e madhe për atë kohë në tërë krahinën e Pogonit, me mijëra vëllime librash, jo vetëm të karakterit fetar, por edhe letrar e artistik. Aty gjeje veprat e klasikëve më të dëgjuar grekë e latinë, vepra të shkrimtarëve kohorë e të dëgjuar, fjalorët më të mirë enciklopedikë të kohës etj. Fatkeqësisht kjo bibliotekë familjare e trashëguar, të cilën Papa Harallambi e kishte me merak dhe të vendosur në ambiente më vete u shkrumbua, kur u dogj fshati në janar të vitit 1944.

K. Beduli

Pse dita e shtunë është caktuar si dita e përkujtimit të të fjeturve (vdekurve)

Qysh në fund të shekullit të 18-të dhe fillimit të shekullit të 19-të shën Makari dhe oshënar Nikodhimi kërkonin që përshpirtjet për të fjeturit të kryhen vetëm ditën e shtunë dhe jo të dielën që është ditë gëzimi për Ngjalljen e Krishtit.

Edhe në kishat tona sot, dita e shtunë është caktuar si dita e përshpirtjeve. Në këtë ditë këndohen psalme të veçanta për të fjeturit. Në to thuhet: "Lutemi për prehjen e shpirtit të shërbëtorit të fjetur të Perëndisë (aksh) që t'i falet çdo faj i bërë me dashje dhe pa dashje...".

"...Që Zoti, Perëndia të vendosë shpirtin e tij atje ku prehen të drejtët..." Në fund bëhet mbyllja "I përjetshëm kujtimi", që shoqërohet

nga psaltët dhe besimtarët. Këto janë çaste mallëngjyese për ata që i kujtojnë dhe për të gjithë të pranishmit, sepse dëgjojnë se Perëndia nuk i harron, por i kujton vazhdimisht shpirtat e shërbëtorëve të fjetur.

Edhe në kalendarin kishtar është përcaktuar kujtimi i të fjeturve ditën e shtunë para të Lidhurit të Mishit dhe të shtunën para Pentikostisë.

Në Uratoren e Vogël që ka Kisha dhe që u botua në vitin 2004 në f. 294 thuhet: "Kemi dhe disponojmë 'urata dhe lutje për të fjeturit... ditën e tretë, të nëntë (të njëzetë) dhe të dyzetë... Kjo bëhet mbas tre muajsh, përsëri mbas gjashtë muajsh dhe së fundi pas një viti.

Por të afërmit dhe familjarët mund t'i kujtojnë sa herë të duan."

Përshpirtjet mund të kryhen çdo ditë përveç ditëve të zakonshme të kreshmëve të mëdha të Pashkëve, për arsye se gjatë kësaj kohe nuk kryhen as Liturgji, as kujtime dhe "ditëlindje [ditët e martirizimit, lindjen në jetën e përjetshme] shenjtoreësh, përveç të shtunës dhe të dielës. Gjithashtu nuk kryhen përshpirtje duke filluar nga e shtuna e L Lazarit deri të dielën e Thomait."

Prandaj Kisha na rikujton neve se dita e përshpirtjeve më e përshtatshme është e shtuna, e cila është dhe ditë pushimi zyrtar.

Kostandin Bozaxhiu

Përmet

Dashuria nuk mund të shuhet me artikuj mendjesh të sëmura...

Të grumbulluara sot në kishën tonë "Lindja e Perëndilindëses" për çështje shpirtërore, mes të tje-rash diskutuam edhe për fushatën e fundit të sulmeve nëpër disa ga-zeta kundër kreut të Kishës Ortho-dhokse dhe Kryebariut tonë, Fort-lumturisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, Anastasit. Ata artikuj janë mbu-shur me shpifje, me trillime ngjar-jesh dhe shtrembërim të qëllim-shëm të fakteve, të shkruara me një gjuhë agresive që na kujton kohën e largët të komunizmit. U intere-suam dhe mësuam se artikull-shkruesi, at Foti Cici, që në këta artikuj shfaqet si një patriot i ku-lluar shqiptar, është një karrierist dhe asgjë më shumë. Është i më-suar me jetën parazite, mësoi 8 vite me radhë në Greqi, me bursë të shtetit grek. Edhe sot e kësaj dite jeton në mitropolinë greke të Toro-


ntos. I themi këto dy fakte të vogla për të kuptuar më thellë hipokri-zinë e tij, sepse na fton të mos duam Kryepiskopin tonë, vetëm për ar-sye se ai është grek. I themi zotë-risë në fjalë dhe mediave që pra-nojnë artikujt e tij, se dashuria e Kryepiskopit për të gjithë anëtarët e Kishës në Shqipëri, pavarësisht nga përkatësia etnike dhe për të gjithë shqiptarët në përgjithësi, nuk mund të shuhet me artikuj me-ndjesh të sëmura dhe të shkrojtura me luksin e salloneve të Kanadasë. Kjo dashuri shprehet tashmë prej 15 vjetësh që Kryepiskopi ynë në kushte shumë të vështira, në situata të jashtëzakonshme, në vështirësi që vetëm ne që i kemi parë e për-jetuar mund t'i kujtojmë, na që-ndron afër dhe na mbështjell me ngrohtësi atërore. Sa herë kemi pasur pranë Kryepiskopin tonë, kur nga themelet ringrinim enoritë

tona në vitet 1992, kur kapërcyem atë kalvar të gjatë të viteve '93-'94, me përkushtimin e tij në vitin '97 dhe ndihmat e tij për kosovarët më 1999 etj. Mori djemtë më të mirë nga krahinat tona dhe pasi i përgatiti, i hirotonisi priftërinj, që të na kryejnë misteret dhe shër-besat e Kishës sonë të shenjtë. Ndërtoi në trevën e Përmetit mbi 10 kisha të reja. Rindërtoi dyfishin e tyre dhe në veçanti monumentet e ndryshme historike të besimit to-në. Djemtë dhe vajzat tona ndjekin kopshtin dhe mësimet në grupet e katekizmit. Edhe njëherë dënojmë këto artikuj dhe mendime. Kup-tojmë fjalët fare mirë, se pas nis-mës së botimit të tyre fshihen që-llime të errëta, mes të cilave edhe të na shkaktajnë përçarje me vë-llezërit tanë grekë dhe të acarojnë marrëdhëniet me fqinjin tonë, Greqinë. Në e dimë më mirë se

kushdo se cila është e mira për mbarëvajtjen e Kishës sonë Or-thodhokse dhe në mënyrë të veça-ntë nuk mund të presim nga njerëz që fare lehtë mund t'i karakteri-zojnë dezertorë. Ata që në ditët e vështira iu shmangën përgjegjë-sive dhe shpresojnë, si gjithë para-zitët, që një ditë të vijnë dhe spe-kullojnë me gjithë këtë vepër ko-losale të realizuar nga Kryepi-skopi Anastas dhe bashkëpunë-torët e tij. Larg duart nga Kisha Orthodhokse! Këtë thirrje u drej-tojmë gjithë qarqeve që nuk e sho-hin me sy të mirë përparimin e pai-magjinueshëm të Kishës sonë në një frymë të plotë mirëkuptimi dhe uniteti.

**Gratë orthodhokse,
Përmet.**

- Botuar në gazetën "PANORAMA",
dt. 16 shkurt 2005 -



Ikona e Himnit Akathist

Nga Himni Akathist

Stanca e parë

Engjëlli kryetar u dërgua nga qielli t'i thotë Hyjlindëses: Gëzohu (3 herë); dhe duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor, çuditej e qëndronte duke i thirrur asaj kështu:

Gëzohu ti, me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu ti, me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.

Gëzohu, o rithirrje e Adamit të rënë; gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës.

Gëzohu, o lartësi, ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi, ku dhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë.

Gëzohu, se Ti je froni i Mbretit; gëzohu, se Ti mban atë që i mban të gjitha.

Gëzohu, o yll, që tregon diellin; gëzohu, o bark që trupëzon hyjinë.

Gëzohu Ti, me anën e së cilës përtërihet krijesa; gëzohu Ti, me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Nga Shenjtorët e muajit

Andonina, martire (1 mars)

Bijë e Nikeas, në Vithini, në veriperëndim të Azisë së Vogël, u kap si e krishterë dhe e tërhoqën deri para antikrishtit maniak, perandorit Maksimian (286-305).

Meqë i foli me zjarr për hyjninë e Krishtit, e rrahin duke e goditur në gjoks, e torturojnë dhe e burgosin. Pastaj e varin në dru, e djegin në brinjë dhe i çajnë mishin, por në kohën që vuan i poshtëron perënditë e kota dhe marrëzinë e mbretit.

Që të ndëshkohet, e rrahin brutalisht. I afrohen xhelatët e paturpshëm dhe çnjerëzorë për të ekzekutuar urdhrin, por arrijnë engjëjt dhe

e ruajnë, mbasi godasin dhe dëbojnë të pacipët. Pastaj, njerëzit bisha i shkojnë nëpër duar heje të skuqur, por ndërkohë nga të çarat e plagëve çlirohet aromë e këndshme! Po kështu edhe kur i shpojnë kyçet. Në vazhdim e shtrijnë mbi një skarë të skuqur, por mbetet e pacënuar. Pas këtyre torturave e burgosin për dy vjet ku kalon shumë mundime, derisa fryma e saj e pathyer fluturon e lirë në Qiell, ndërsa po e mbytnin në liqenin e Nikeas, të mbyllur në një thes.

Kremtohet edhe më 12 qershor, ndërsa nga troparet e saj nënkup-tohet si virgjëreshë.

Theofilakti i Nikomidhisë (8 mars)

Çuditërisht, jetëshkruesi i tij bashkëkohor nuk na përmend origjinën dhe datat e kronologjisë së jetës së tij. Kështu, ato u llogaritën përafërsisht si vijon: U lind në Lindje më 765, shkoi në Konstandinopol më 780, u bë murg më 785, u bë episkop më 800 dhe fjeti ndërmjet viteve 840 dhe 845.

Në kryeqytet u lidh me oficerin madhor, shën Tarasin (25 shkurt), i cili kur u bë patrik e dorëzoi në hierark të Nikomidhisë, në bregdetin aziatik të Propontit. Më parë e dërgoi -bashkë me Mihailin, kryebariun e mëvonshëm të Sinadhëve (23 maj), - të murgërohej në manastirin që kishte formuar në grykën e ngushticës së Bosforit.

I virtytshmi dhe arsimuari mitropolit Theofilakti zhvilloi një veprimtari të admirueshme: ndërtoi kisha dhe spitale, në të cilat u shërbente të sëmurëve edhe ai vetë, kujdesej për jetimët dhe të vejat, dhe mëshironte me shumë mënyra.

Por, në vitet e mëpasme u ringjall ikonomakia (lufta kundër ikonave). Njëherë, patriku shën

Nikifori (2 qershor), vizitoi perandorin ikonomak, Leonti V (813-820), duke pasur me vete krypriftërinj të zgjedhur, ndërmjet të cilëve shenjtorët Emilianin e Kizikës (8 gusht), Efthimin e Sardhëve (26 dhjetor), Josifin e Selanikut (14 korrik), Gjergjin e Mitilinit (7 prill), Mihailin e Sinadhëve dhe oshënarin tonë.

Mbreti mbeti i palëkundur në pozitat e tij dhe nuk pranoi të korrigjohej, megjithë argumentet biblike për ikonat e shenjta. Atëherë ndërhyri Theofilakti dhe i profetizoi “fatkeqësi të tmerrshme” (Leonti u vra natën e Krishtlindjeve, më 820).

Perandori u zemërua dhe shenjtë u internua në një vend të fortifikuar bregdetar në jugperëndim të Azisë së Vogël, ku vazhdoi përpjekjet asketike dhe bamirësitë e tij. Fjeti atje pas plot tridhjetë vjetësh.

Në kohën e perandoreshës shën Theodhora (11 shkurt), lipsani i tij i shenjtë u transportua në një kishë që kishte ndërtuar ai vetë në Nikomidhi.

Senufi, oshënar (25 mars)

Sinaksarët nuk japin jetën e tij, por vetëm e quajnë çudibërës. Sipas një hipoteze, që ka lidhje me një zbulim të rëndësishëm arkeologjik, siç do të shpjegojmë më poshtë, oshënar i njësohet me asketin me të njëjtin emër të Nitrisë, në perëndim të deltës së lumit Nil. D.m.th. ruhet tregimi i një igumëni të një manastiri të Selanikut, ku rrëfen si më poshtë:

Senufi gjatë një vegimi hyjnor dëgjoi dikë, Krishtin, që e nxiste të udhëtonte për në Manastirin e Latomeve (ose Latomit = gurnxjerrës), në Selanik, ku do Ta shikonte. Shkoi, por murgjit nuk e kishin, që t'ia tregonin, ikonën për të cilën ai kishte ardhur.


Kthehet në Egjipt, por përsëri zëri e urdhëron të shkojë në Selanik, për të parë ikonën e Çlirimtarit, para se të vdesë po atje, në Selanik. U bind dhe vërtet, e pa ikonën,

e cila u zbulua pas një tërmeti, gjatë të cilit ra suvatimi që e mbulonte!

E çuditshme është se ky mozaik u zbulua në shekullin e kaluar në Selanik dhe u prezantua shkencërisht (1929), duke pasur të gjitha karakteristikat dhe mbishkrimet që jep tregimi. Bëhet fjalë për një kompozim madhështor dhe shumë të bukur, nga pjesët më të çmuara të artit bizantin, që paraqet lavdinë e Krishtit, siç e përshkruan Apokalipsi dhe libra të tjerë të Biblës. Është mozaiku i vetëm i kishës së vogël të Oshënar Davidit, e cila u përdor si “Katholikon” (= kisha qendrore manastriale) e manastirit të dikurshëm të Latomeve. Shtrihet në apsidë të ajodhimës dhe datohet në shek.V dhe VI.

Nëse do të marrim parasysh se Nitria lulëzoi midis shekujve IV–VII, atëherë mund të supozojmë se shenjtë jetoi në shek.VII.

At Justini



Libri “VAJTIMI PËR ATDHEUN E HUMBUR në të Dielat e të lidhurit”

është një ndihmë shpirtërore për ata që nisin Kreshmën e Madhe dhe për të gjithë besimtarët në këtë periudhë që na përgatit për Pashkët

**Adresat e faqeve në Internet dhe ajo e E-mail-it,
të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, janë:**

Internet: www.orthodoxalbania.org

E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

Gjenevë

Këshilli Botëror i Kishave aprovon vendimmarrjen me konsensus

Në dhjetëditorin e fundit të shkurtit në Gjenevë u zhvillua mbledhja e Komitetit Qendror të KBK, mbledhja e fundit para asamblesë së Porto Alegres - Brazil, në vitin 2006. Përgatitja e kësaj asambleje ka të bëjë me përbalimin e sfidave të reja, duke kufizuar disa veprimtari, por njëkohësisht duke rritur cilësinë e gjithë punës së KBK, duke gjetur mbështetje në rrënjët më të thella të spiritualitetit të krishterë.

Aspekt themelor i ndryshimeve që po përjeton KBK ishte ndryshimi i rregulloreve dhe adoptimi i modelit të vendimmarrjes me konsensus. Ky modifikim do të lejojë forcimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të kishave anëtare.

Nevoja e këtij ndryshimi u shfaq gjatë punimeve të komisionit special për pjesëmarrjen e kishave orthodhokse në KBK. Komisioni kërkoi mjete për të suguruar që zëri i orthodhoksëve të ishte i ndjeshëm në



vendimet e Këshillit Botëror të Kishave. Sistemi "parlamentar" sillte atë, që zëri i minorancave rregullisht humbës gjatë një votimi, ndaj duhej gjetur një alternativë. Ndaj komisioni i kushtoi një dokument nevojës për konsensus. Ky tekst kaloi mjaft etapa shqyrtimi në gjirin e organizatës, duke u pasuruar me elementë të rinj.

Ndërkohë mjaft komisione të KBK kishin nisur të punojnë sipas këtij modeli, ndërsa të tjerë ishin në proces testimi. Më në fund, gjatë mbledhjes së Komitetit Qendror, më 21 shkurt, u paraqit dhe u aprovua një propozim, i cili e bën procedurën e kërkimit të konsensusit rregull për çështjet kryesore.

Korresp. i "Ngjalljes"

A e ka gjetur Princi Charls shtëpinë e tij të vërtetë shpirtërore?...

- sipas gazetës "The Guardian" -

Pasi përshkruan një vizitë private dhe të fshehtë të Princit trashëgimtar të Britanisë në Malin e Shenjtë, i treti brenda një viti, artikulli vazhdon:

Sipas miqve dhe të njohurve të princit, kreu i ardhshëm i Kishës Anglikane ka rënë në dashuri me besimin orthodhoks. Madje deri në atë pikë, sa e ka mbushur një pjesë të shtëpisë së tij në Highgrove me ikona të çmuara bizantine, të cilat besohet se në shumicën e tyre e kanë origjinën nga Athosi, vendi më i shenjtë i Orthodhoksisë.

Princi, si shoku i tij, kompozitori Sër John Tavener, i cili u kthye në besimin orthodhoks në vitin 1977, thuhet se është mjaft i prirur nga spiritualiteti i fortë i Kishës Orthodhokse.

Që nga mbretërimi i Stjuartëve nuk ka pasur një trashëgimtar të fronit me një interes intelektual kaq të dukshëm ndaj fesë. Për vite Charlsi, që do ketë edhe titullin e Mbretërisë së Fesë (anglikane) kur të bëhet mbret, ka treguar një inte-

res të paprecedent edhe për besime të tjera, si Islami dhe Budizmi.

Por, takimet e tij të rregullta me At Efraimin, igumenin e Vatope-dhit - manastiri i tij i preferuar në Mal - i ka hedhur benzinë zjarrit të spekulimeve, se princi është duke u prirur nga krishterimi lindor, megjithëse kjo mohohet me ashpërsi nga oborri.

Dëshmitarë thonë se Charlsi mbërriti në Athos pak ditë pas vdekjes së Princeshës Diana dhe ishte Efraimi që e nxiti të afrohej me besimin (orthodhoks)...

"Njerëzit harrojnë se Orthodhoksia është në familjen e tij", - thotë Arqipiskopi Grigor i Thiatërës, që drejton në Britaninë e Madhe një komunitet të fuqishëm orthodhoks prej 500 mijë vetësh.

"Një nga hallat e Charlsit, Dukeshës e Madhe Evgenia, është shpallur shenjtore orthodhokse, pasi ajo u vra në Moskë ku ishte vendosur në një manastir. Gjysha e Charlsit nga babai, Aliki, ishte murgeshë për një pjesë të madhe të jetës. Ajo e fliste shumë mirë greqishten dhe vitet e saj të fundit,

kur erdhi në Londër, ajo bëri një kapelë orthodhokse në Buckingham Palace", shton episkopi.

Si qendra religjioze e Orthodhoksisë lindore, Athosi është një magnet për pelegrinë që i janë dedikuar besimit. Shumë prej tyre - siç e dëshmon numri gjithmonë në rritje i murgjve nga BE, SHBA, Kanada apo Australia - nuk kthehen më që aty. Edhe midis evropianëve të pasur apo atyre me gjak blu, ky vend me bimësi të harlisur shihet si një mundësi ikjeje dhe dezin-toksikimi nga realiteti i përditshëm.

I ati, Princi Filip, i lindur në Korfuz dhe që ashtu si Charlsi është një anëtar nderi i Vëllezërve të Malit të Shenjtë, kaloi në Anglikanizëm nga Orthodhoksia kur u martua me Mbretëreshën....

...Zyrtarisht St Jamme's Palace thotë se vizitat e Princit në Malin e Shenjtë janë "çështje personale". Dhe jo në pozitën e Princit të Uellsit, trashëgimtarit të fronit dhe se ai është i interesuar për arkitekturën dhe spiritualitetin e Athosit...

Korresp. i "Ngjalljes"

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, PRILL 2005

1 E Premte + Oshg. Maria e Egjiptit. Osh. Makari. (III e Akathistit.)

2 E Shtunë + Osh. Titi. Dëshg. Theodhora. Dësh. Amfiani dhe Edhesi.

3 E DIEL + III KRESHMËS (Falja e Kryqit). Osh. Nikita, Josif himnog., Iliri.

6 E Mërkurë + Eftihi i Kon/pojës. 2 dësh. në Askalon. Osh. Grigor sinaiti.

8 E Premte + Ap. Herodioni, Rufi, Hermesi nga të 70. (IV e Akathistit.)

9 E Shtunë + Dësh. Efipsiki. Osh. Vadimi. Dësh. të rinj Rafaili, Nikolla, Irini.

10 E DIEL + IV KRESHMËS (Joani i Shkallës). Dësh. Perikliu, Sofokliu.

13 E Mërkurë + Martini i Romës. Dësh. Elefteri, Zoili. Osh. Theohari, Apostoli.

15 E Premte + Dësh. Krishenti. Leonidhi i Athinës. (Akathisti i plotë.)

16 E Shtunë + Dëshg. Agapi, Irini, Galinia, Harisa, Hjonia, Kalisa.

17 E DIEL + V KRESHMËS (Maria e Egjiptit). Hierod. Simeoni i Persisë.

20 E Mërkurë + Osh. Theodhor Trihini. Ap. Zakeu nga 70. Dësh. Gavriili fëmijë.

22 E Premte + Ap. Nathanaili. Osh. Theodhor sikeoti. Dësh. Nearku.

23 E Shtunë + Sh. Llazari. Dëshm. Gjergj Tropeprurësi. (Sivjet festohet më 2 maj.)

24 E DIEL + # E DAFINAVE. Oshg. Elisabeta çudibërëse. Hierod. Valentioni.

25 E Hënë + E MADHE. Josifi i Dhiatës së Vjetër. Ungj. Marku. (Sivjet fest. më 3 maj.)

26 E Martë + E MADHE. (Paravolia e 10 Virgjërëshave.) (Psalet Himni i Kasianisë.)

27 E Mërkurë + E MADHE. Larja e këmbëve nga Zoti Krisht. (Bëhet Efqeli.)

28 E Enjte + E MADHE. Darka Mistike. (Lexohen 12 Ungjijtë.)

29 E Premte E MADHE. Pësimet e Zotit Krisht. (Psalen Vajtimet.)

30 E Shtunë + E MADHE. Varrimi i Zotit Krisht. Zbritja në Ferr.

KISHA E KRYEENGJËJVE NË GJIROKASTËR

- e drejtë ende e mohuar -

Indiferenca kronike e autoritetit bashkiak të Gjirokastrës, e kombinuar shpeshherë me synime grabitjeje ose shfrytëzimi të pasurisë kishtare, e ka shndërruar zonën përreth kishës së shenjtë të Kryeengjëjve, në lagjen Varrosh të Gjirokastrës, në territorin më të rrënuar urbanistik të qytetit.

Kjo indiferencë lidhet me padrejtësinë historike që u bë pas vitit 1967, kur deklarimin zyrtar të shtetit si ateist, e shoqëroi shtetëzimi i pasurisë kishtare, dhe kjo procedurë përfshiu madje edhe varrezat e të krishterëve orthodhoksë, që ndodheshin në zonën përreth Kishës së Taksiarhëve (Kryeengjëjve).

Në këtë kuadër, ato i shkulën me buldozer, me pretekstin se do të riorganizonin urbanizimin e zonës. Kështu u realizua një krim i trefishtë: nga njëra anë u shtetëzua prona e kishës; së dyti, u shkatërruan varret e parardhësve të Komunitetit Orthodhoks të qytetit, që do të thotë përpjekje për të zhdukur një dëshmi historike dhe shpirtërore. Gjithashtu, bëhet fjalë për një ndërhyrje të pastudiuar, pa kritere që në vend që të ngrinte vlerat e zonës, e shndërroi atë në një shembull për t'u shmangur urbanizimi. Nga një mjedis me pemë dhe ku ta kishte ënda të shkoje, u kthye në një grumbull të shëmtuar ndërtime pa kriter, ngritur mbi kocka njerëzish, pasi nga nxitimi mjaft prej eshtrave nuk u arrit që të hiqeshin.

Duket, pra, qartazi që e gjithë kjo histori e përshkruar shkurtimisht synonte qartazi në shthurjen

e plotë të Komunitetit Orthodhoks të qytetit, gjë që e vërtetojnë plotësisht edhe zhvillimet paskomuniste.

Në territorin përreth kishës (për më tepër monument kulture me vlera të papërsëritshme), në kohën e regjimit komunist u ndërtuan godina joestetike për shkolla, konvikte, magazina etj. si dhe terrene

është rikonstruktuar me metodat shkencore dhe bashkëkohore dhe funksionon si një qendër shpirtërore që me kryerjen e mistereve hyjnore dhe shërbesave të Kishës sonë të shenjtë rrezaton në gjithë mjedisin gjirokastrit.

Ndërkaq madhështia e këtij monumenti kishtar dhe kulturor që ndron larg rrezatimit që i përket

të gjithë territorit, që të realizohet rrethimi, me synim që fëmijët e konviktit të ndjejnë siguri më të madhe ndërsa në shkollë programi mësimor të realizohet më me qetësi.

E ndërsa manifestohet gjithë kjo neglizhencë fyese ndaj kërkesave të Komunitetit Orthodhoks, akoma nga ana e autoritetit bash-



Në foto: Kisha e Kryeengjëjve në Gjirokastrë dhe një pamje se si ishte para ndërtimeve në territorin e saj.

sportive. Kështu Komisioni i famshëm i Kthimit të Pasurive në vitin 1994, të vetmen gjë që u ktheu orthodhoksëve ishte kisha, e cila gjatë persekutimit ishte shndërruar në depo dhe nga kjo pikëpamje ishte në gjendje të mjeruar. Nga rreth 11 dynymë, pra, në zonën me intensitet zhvillimi, shteti i ktheu kishës vetëm rreth 500 metra katrorë të godinës!

Në vazhdim nga ana e Kryepiskopit Anastas u krye një punë kolosale për rikonstrukcionin e kishës së Taksiarhëve, gjë e cila dha rezultatet e veta. Sot kjo kishë

dhe promovimit dhe nuk krijon lehtësirat e nevojshme për besimtarët orthodhoksë dhe kjo sepse akoma është i rrethuar nga ndërtesat publike, një pjesë e mirë e të cilave janë rrënoja të rrezikshme dhe antiestetike.

Përveç shkollës që funksionon, Drejtoria Arsimore mban akoma peng një sipërfaqe të madhe me mbeturiana ish-magazinash, që sot janë të papërdorura.

Autoritetet lokale dhe të arsimit tregojnë gjithashtu një indiferencë të pashpjegueshme për një bashkëveprim me synim përmirësimin e

kiak bëhet veshi i shurdhër për dhënien e një trualli të vogël për ndërtimin e kishës për varrezat, një kërkesë sistematike kjo e orthodhoksëve.

Ligji i pronave përcakton me rreptësi që kur godinat shtetërore që janë ndërtuar mbi pronë të huaj dhe nuk përdoren për qëllimin fillestar i kthehen ish-pronarit. Në këtë kuadër do të duhet që nga ana e komunitetit të enorisë historike të "Taksiarhut" në Varrosh të shtohen përpjekjet.

Korresp. i "Ngjalljes"

Me fuqi të ripërtërira, për të vazhduar punën e tij

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumluturia e Tij Anastasi, në fillim të muajit dhjetor 2004 iu nënshtrua një operacioni në gjëndrat tiroide, në spitalin "Evangjelizmos" të Athinës. Operacioni u krye me sukses të plotë.

Më 1 janar 2005, Kryepiskopi kreu Liturgjinë Hyjnore në kishën "Ungjillëzimi i Hyjlindës", në Tiranë dhe më 3 janar kryesoi mbledhjen e Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Duke ndjekur terapinë përkatëse, Kryepisko-

pi Anastas ka bashkërenduar të gjitha punët e Kishës dhe ato të veprimtarisë shkencore. Shëndeti i tij u rimëkëmb plotësisht dhe me fuqi të ripërtërira u kthye sot në Tiranë, për të vijuar punën e tij kishtare dhe shoqërore.

Tiranë, 18 shkurt 2005.